



Një vend për t'u rritur:
Komuna kushtuar
fëmijëvet



Vendi për t'u rritur përmes syve të fëmijëve dhe përvojave lokale

Në kuadër të projektit “Një Vend për t'u Rritur: Komuna të dedikuara për fëmijët”, KMOP Shkup zbatoi një sërë aktivitete që synojnë rritjen e dukshmërisë, me qëllim përf forcimin e zërit të fëmijëve, promovimin e të drejtave të tyre dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së tyre aktive në vendimarrje - veçanërisht në nivel lokal.

Në këtë drejtim, u realizuan video podkaste me 19 fëmijë, si dhe u regjistruan dëshmi video me 7 përfaqësues nga komunat e Velesit, Vinicës, Dibrës, Gostivarit dhe Kisella Vodës.

Fëmijët kanë diçka për të thënë, dhe të rriturit dëgjojnë!

Yje të vegjël dhe të mëdhenj nga pesë komuna morën mikrofonin dhe ndanë të vërtetën e tyre.

❖ Ivana, Ana Todorova, Ana, Erika dhe Oleg nga Vinica; Dion, Anika, Ana dhe Damjan nga Gostivari; Matej, Leona dhe Antonia nga Kisella Voda; Kristijan, Jana, Mihail dhe Izabela nga Velesi; dhe Vedija, Edina dhe Merxhiza nga Dibra - diskutuan gjërat më të rëndësishme, pse është i rëndësishëm zëri i fëmijëve, cilat janë të drejtat e tyre dhe si duan që të duket komuna e tyre.

Historitë e tyre mbajnë tituj të fuqishëm:

- ☐ Gostivar: “Zëri jonë” – një zë që lidh dhe frymëzon
- ☐ Vinicë: “Terkota” – ritmi dhe gjallëria e fëmijërisë
- ☐ Kisela Voda: “Njësoj, por jo në kornizë” – diversitet dhe pranim
- ☐ Veles: “Arkitektura e fëmijërisë” – çdo fëmijë një ndërtues i botës së vet
- ☐ Dibrë: “E vogël, por me zë të lartë” – dëshmi se çdo zë ka fuqi

Fëmijët zgjedhën temat, bënë pyetje, drejtuan biseda dhe krijuan mesazhet që donin që të rriturit t'i dëgjonin – nga perspektiva e tyre, me fjalët e tyre.

Podkastet janë plot frymëzim, ndershmëri dhe ide për një të nesërme më të mirë – dhe kjo është arsyeja pse ia vlen t'i [dëgjosh](#)!





Një vend për t'u rritur:
Komuna kushtuar
fëmijëve

Video dëshmi

Me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe **promovimin e praktikave të mira**, si dhe për t'u mundësuar qeverisjeve të tjera lokale të frymëzohen dhe të zbatojnë qasje të suksesshme, u zhvilluan intervista video me përfaqësues të qeverisjeve lokale të përfshira në projekt.

Përmes këtyre intervistave, ata ndanë njohuritë, përvojat dhe praktikat e tyre personale të zhvilluara gjatë projektit, duke folur për:

- ✓ Ndryshimet pozitive që kanë vënë re në komunitet,
- ✓ Aspektet më të rëndësishme të përfshirjes së fëmijëve në planifikimin lokal,
- ✓ Si ka ndryshuar projekti pikëpamjen e tyre mbi të drejtat dhe pjesëmarrjen e fëmijëve,
- ✓ Sfidat me të cilat janë përballur dhe mënyrat se si i kanë kapërcyer ato,
- ✓ Këshilla dhe rekomandime për komunat e tjera që duan të përfshijnë fëmijët në proceset e vendimmarrjes.



Thirrje për veprim

Përmes këtyre përmbajtjeve promovuese, u bë një thirrje e qartë për të gjithë palët e interesuara - të vazhdojnë të mbështesin dhe zhvillojnë iniciativa që përqendrohen te fëmijët, të përkthejnë frymëzimin në hapa dhe politika konkrete dhe të krijojnë mjedise në të cilat zërat e fëmijëve dëgjohen, respektohen dhe merren parasysh në vendimmarrje.

Mënyra të tilla të përfshirjes së fëmijëve dhe të rriturve ofrojnë njohuri autentike dhe mesazhe të forta nga vetë fëmijët dhe aktorët lokalë, duke rritur kështu ndërgjegjësimin dhe duke kontribuar në krijimin e mjediseve të përshtatura për secilin fëmijë.



Projekti financohet nga
Bashkimi Evropian

